

Cilat janë disa nga pasojat e korrupsionit?

● Në aspektin ekonomik:

- Korrupsioni dëmton konkurrencën e lirë; si konsekuencë, ulet cilësia e mallrave dhe shërbimeve dhe rritet kostoja e tyre.
- Korrupsioni kontribuon në rënien e investimeve; kjo për faktin se investitorët e huaj humbin besimin tek shteti, kurse bizneset vendore duhet të ndajnë fonde për ryshfet.
- Korrupsioni ndikon në rritjen e ekonomisë joformale; si rrjedhojë, të hyrat buxhetore nga tatimet zvogëlohen.
- Shkalla e lartë e korrupsionit shkakton ekonominë e vendit dhe rritet varfërinë në tërë popullatën.

● Në aspektin e qeverisjes së shtetit:

- Miratohen projekte që ofrojnë mundësi për ryshfet e përfitime personale për zyrtarët publik, ndërsa ka mangësi të projekteve strategjike.
- Ulet cilësia e shërbimeve publike.

- Pagat për punonjësit civil ngelin të ulëta kurse përgjegjësia nuk lidhet shumë me cilësinë e punës.
- Ulen investimet dhe efikasiteti tek ndërmarrjet në pronësi shtetërore.

● Në aspektin socio-ekonomik:

- Korrupsioni është shkaktar dhe rezultat i varfërisë.
- Mirëqenia personale vlerësohet gjithnjë e më shumë kundrejt mirëqenjes shoqërore.
- Mungon vëmendja e duhur për problemet socio-ekonomike.
- Korrupsioni si fenomen përlligjet dhe bëhet shumë e vështirë të luftohet; krijohen perceptime të gabuara nga shoqëria ku njerëzit nuk arrijnë të dallojnë mirë nëse janë të pakënaqur me korrupsionin, apo nuk po sigurojnë përfitime të mëdha personale.

CILAT JANË STRATEGJITË ANTIKORRUPSION?

Vende të ndryshme përdorin strategji të ndryshme për të parandaluar dhe për të luftuar shfaqjen e korrupsionit. Disa nga strategjitë më të njohura mund të jenë:

- Të bëhet ndarja e posteve politike dhe shtetërore;
- Të mos lejohen shërbyesit civil të marrin pjesë në aktivitete komerciale;

- Të kërkohen dëshmi të transparencës dhe ligjshmërisë së të ardhurave dhe shpenzimeve të partive politike;

- Të deklarohen të ardhurat e çdo zyrtari të lartë;

- Të plotësohet legjislacioni me definicione të qarta për veprat e korrupsionit;

- Të përmirësohen procedurat rreth prokurimit publik dhe privatizimit të pronave shtetërore;

- Të krijohen kushte dhe metoda të qarta për punësim dhe avancim për të gjithë shërbyesit civil;

- Të vendosen procedura të qarta të cilat pikë synim kanë mirëqënien e qytetarëve.

Kush është përgjegjës për ndalimin e korrupsionit në Kosovë?

Institucionet kryesore përgjegjëse për luftimin e korrupsionit në Kosovë janë: Agjencia Kundër Korrupsionit (AKK), Policia, Prokuroria dhe Gjykatat. AKK është organ i pavarur i specializuar për zbatimin dhe hartimin e politikave kundër korrupsionit.

Çfarë mund të bëjmë ne që të zvogëlojmë korrupsionin?

Të raportojmë çdo rast të korrupsionit në AKK, në numrin e telefonit pa pagesë: **0800 10 800**

Të gjitha thirrjet janë konfidenciale dhe të besueshme

Ju gjithashtu mund të kontaktoni personalisht AKK-në në adresën:

Agjencia Kundër Korrupsionit | Rruga "Nazim Gafurri", Nr. 31, Prishtinë, Kosovë.

Tel: 00 381 (0) 38 518-907 dhe 038 200 10-716.

E-mail: info@akk-ks.org | Faqja e internetit: www.akk-ks.org



Qendra për studime të avancuara FIT
E-mail: info@fit-ks.org
www.fit-ks.org



Ky projekt u financua përmes grantit të Ambasadës Amerikane në Prishtinë. Mendimet, përfundimet dhe konkludimet apo rekomandimet e shprehura këtu janë të Autorit(ëve) dhe jo medoemos pasqyrojnë qëndrimet e Departamentit të Shtetit



**BËHU I PËRGJEGJSHËM,
THUAJ JO KORRUPSIONIT**



ÇFARË ËSHTË KORRUPSIONI?

Çdo keqpërdorim i pushtetit apo sjellje tjetër e personit zyrtar, personit përgjegjës apo ndonjë personit tjetër me qëllim të arritjes së një përparësie apo përfitimi të kundërligjshëm për veten e tij apo për të tjerët paraqet korrupsion.

Me fjalë të tjera, korrupsioni paraqet shpërdorim të fuqisë publike për përfitime personale.



KU SHFAQET KORRUPSIONI?

● Korrupsioni mund të shfaqet si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat. Në sektorin publik korrupsioni shfaqet më së shpeshti në politikë, në polici dhe në gjyqësor. Korrupsioni në edukim (përfshirë korrupsionin në universitete) mund të shfaqet si në sektorin publik ashtu edhe në atë privat.

CILAT JANË FORMAT E KORRUPSIONIT

MASHTRIMI

Përfshin çdo sjellje kriminale dhe të pandershme që ka për qëllim përfitimin personal apo financiar në mënyrë të paligjshme të personit i cili ushtron atë sjellje.

Shembull:

Një kompani fiton tenderin për të ndërtuar një shkollë të re mirëpo, ndërtimi i asaj shkolle rezultoi në jetë shumë të dobët pasi që kompania në fjalë ka investuar shumë më pak se shuma e paraparë duke i mbajtur paratë tepricë për vete.

NEPOTIZMI

Një shërbyes publik siguron pozita të punës për familjar.

Shembull:

Një zyrtar i lartë merr në punë një familjar të tij pa i plotësuar kriteret e konkursit.

FAVORIZIMI

Ofrimi i shërbimeve dhe të mirave duke u bazuar në pëlqime personale si psh: feja, etniciteti, apo preferencat personale.

Shembull:

Nëse një nxënës ndjek kursin e matematikës tek arsimtari i matematikës, ai merr notë më të lartë pa meritë vetëm pse shkon në kurs.

PËRVETËSIMI

Përfshin vjedhjen e resurseve nga personat të cilët kanë autoritet dhe kontroll në ato resurse.

Shembull:

Stafi i spitalit publik vjedhin barna në mënyrë që t'i shesin ato tek barnatoret private.

MITO (RYSHFETI)

Përfshin premtimin, ofertën, apo dhënien e të mirave materiale të cilat në mënyrë jo adekuate ndikojnë në vendimet e shërbyesëve publik.

Shembull:

Mjekët pranojnë para në mënyrë që një pacient të futet në operacion jashtë rradhës.

ZHVATJA

Praktika për përfitime personale duke përdorë kërcënime dhe shantazhe. Personi i tillë përdor mjete e mënyra jo të ndershme për të marrë nga shoqëria dhe shteti më shumë se që i takon apo atë që nuk i takon fare.

Shembull:

Nëse një universitet privat nuk i përmbush kushtet që të operojë, ai automatikisht duhet të mbyllet. Sidoqoftë, në rast se Inspektori vendos që ta lejojë universitetin të operojë dhe si shpajmim kërkon një pagë mujore nga ata, ky është rast i zvatjes.

Forma të tjera të korrupsionit janë edhe:

- Mashtrimi dhe ndërhyrja në zgjedhjet qeveritare të vendit për përfitime personale;
- Dënimi i personave të cilët informojnë për sjellje të pahijshme të zyrtarëve;
- Pasurimi jo ligjor i zyrtarëve të cilët pastaj nuk mund të shpjegojnë pasurinë e tyre në lidhje me të ardhurat të cilat ligjërisht i fitojnë;
- Përvetësimi i pronave të shtetit;
- Përdorimi jo i ligjshëm i informacioneve shtetërore konfidenciale;
- Përhapja e informacioneve të pasakta;
- Pengimi ose ndërhyrja në urdhërat shtetëror;
- Moskryerja e punëve të caktuara për qëllime personale.

SË BASHKU
KUNDËR
KORRUPSIONIT